

V E N D I M
Nr. 540, datë 31.10.2002

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE TË NXËNËSVE, STUDENTËVE, FËMIJËVE QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8718, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", të shkronjës "c" të nenit 32 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 63 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Studentëve dhe nxënësve u jepet bursë ose gjysmëbursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, çdo vit, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

2. Bursë ose gjysmëbursë përfitojnë:

a) nxënësit dhe studentët që vazhdojnë studimet larg vendbanimeve të tyre dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

b) nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 8-vjeçare brenda rrezes prej 5 km ose transport të siguruar e që vendosen në konvikt;

c) nxënësit dhe studentët që kanë përfituar statusin e jetimit në të gjitha kategoritë e shkollave;

ç) studentët e divorcuar;

d) secili nga studentët bashkëshortë që ka fëmijë;

dh) nxënësit dhe studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.

Nxënësit dhe studentët që trajtohen me bursë ose gjysmëbursë, sipas shkronjave "c", "ç", "d", e "dh" e përfitojnë atë edhe gjatë pushimeve verore.

e) studentët që vazhdojnë studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degët Matematikë e Fizikë;

Studentët, që kanë përfituar bursë sipas këtij kriteri, trajtohen deri në përfundim të studimeve, jashtë kriterit ekonomik.

Për këtë kategori studentësh, bursat shpërndahen nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, sipas planit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në përputhje me kuotat e pranimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave për këto degë.

ë) nxënësit në arsimin e mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me të gjitha notat 10-ta, marrin bursë të plotë;

f) studentët që kanë mbaruar vitin akademik paraardhës me të gjitha notat 10-ta, marrin bursë të plotë;

g) studentët e viteve të dyta e lart, që plotësojnë kriteret ekonomike jashtë bursave të ndërmjetme të universiteteve, përfitojnë bursë sipas planit të shpërndarjes, të hartuar nga Drejtoria Ekonomike e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për të gjitha universitetet, brenda numrit të bursave të vitit të parë, të miratuara me këtë vendim. Numri i bursave për këtë kategori studentësh është deri në 100.

3. Bursë ose gjysmëbursë nuk përfiton:

a) nxënësi dhe studenti i familjes, që ushtron veprimtari private, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

b) nxënësi dhe studenti i ndarë nga trugu familjar.

Për efekt trajtimi me bursë, merren për bazë të ardhurat ekonomike të të gjithë familjes nga e cila është ndarë nxënësi apo studenti dhe certifikata familjare para ndarjes.

c) më shumë se një person në familje, përveç rasteve të parashikuara në shkronjën "ç", "d", "dh" dhe "f" të pikës 2 të këtij vendimi;

ç) nxënësi i shkollës 8-vjeçare, të mesme dhe studenti që nuk e merr klasën apo vitin;

d) studenti që vazhdon studimet me kuotë dytësore.

4. Studentët, pavarësisht nga kriteret, nuk mund të përfitojnë bursë apo gjysmëbursë më tepër se vitet e shkollimit, të përcaktuara në planin mësimor në degën përkatëse.

5. Këshillat e qarqeve, me propozimin e këshillave të komunave dhe të bashkive, kanë të drejtë të miratojnë bursë ose gjysmëbursë për vitin e parë jashtë kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, brenda planit të vitit të parë, ku për çdo rreth planifikohen jo më shumë se 3 bursa. Këshilli Bashkiak i Tiranës ka të drejtë të japë deri në 30 bursa. Këto bursa duhet të nënshkruhen, për efekt plani, edhe nga drejtori i drejtorisë arsimore përkatëse.

Nxënësi dhe studenti e përfiton këtë bursë gjatë gjithë viteve të planifikuara të shkollimit. Në rastet kur nxënësi ose studenti, që përfiton këtë lloj burse, ndërpret shkollën për arsye të ndryshme, i humbet e drejta e përfitimit të bursës.

Nxënësve dhe studentëve u ruhet bursa kur humbasin vitin shkollor për arsye shëndetësore ose fatkeqësi familjare.

6. Bursistët jetimë të shtëpive të fëmijës, të shkollave të mesme dhe të larta, nxënësit e Institutit të fëmijëve që nuk shikojnë dhe nxënësit e Institutit të fëmijëve që nuk dëgjojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore, sipas normave të përcaktuara në natyrë, sipas pasqyrës nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Këto kategori nxënësish përfitojnë falas nga shteti shërbimin mjekësor, në kuotën deri në 200 lekë në muaj për nxënë, si dhe shërbimin shëndetësor dentar.

Kuotat e ushqimit dhe të shpenzimeve të vogla, për nxënësit e institucioneve të arsimit special, me konvikt, të jetë sipas pasqyrës nr.5/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Fëmijët e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqimi (drekë) dhe me mjete shkollore. Kuota ushqimore për këtë kategori nxënësish është 70 lekë në ditë.

Mësuesit dhe edukatorët e institucioneve të mësipërme gëzojnë të drejtën e një vakti (drekë) me vlerë deri në 70 lekë në ditë. Kuota financiare ushqimore ditore për studentët të jetë sipas pasqyrës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nxënësve dhe studentëve jetimë, bursistë, u jepen lekë në dorë për nevoja vetjake, përkatësisht 500 dhe 700 lekë në muaj. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe kur kurohen në institucionet shëndetësore.

7. Niveli i bursave dhe i kuotave financiare të ushqimit për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë sipas pasqyrave nr. 3 dhe nr. 4 "Për nivelin e bursave dhe të kuotave financiare ditore", që i bashkëlidhen këtij vendimi. Kuota ushqimore për nxënësit dhe studentët në lekë të jetë sipas pasqyrës nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe kuota financiare, në natyrë për ushqim, e studentëve të jetë sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Bursa ose gjysmëbursa për studentët jepet me lekë në dorë.

Bursa ose gjysmëbursa për vitet e para të shkollave 8-vjeçare, të mesme dhe të larta miratohet me vendim të këshillit bashkiak apo të këshillit të komunës, ku ka vendbanimin e përhershëm nxënësi apo studenti, si dhe nga prefektura përkatëse.

8. Drejtoritë arsimore në rrethe bëjnë shpërndarjen e planit të bursave, duke përfshirë edhe bursat jashtë kriterit, që miratohen nga këshillat e qarqeve apo nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, brenda planit të vitit të parë.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e të gjitha niveleve për vitet e para, të nënshkruhen, për efekt plani, edhe nga drejtori i drejtorisë arsimore përkatëse, në përputhje me planin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Vendimin origjinal të dhënies së bursës studentit apo nxënësit, bashkia apo komuna ia dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorisë arsimore përkatëse. Bashkia apo komuna i dërgon, po në rrugë zyrtare, vendimet përkatëse dhe listën e bursistëve në shkolla dhe universitete dhe një kopje në Drejtorinë Ekonomike të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Asnjë dokument zyrtar nuk i jepet në dorë personit të interesuar për bursë.

Bursa e studentëve të vitit të parë të shpërndahet vetëm pasi të jenë dërguar zyrtarisht listat nga drejtoritë arsimore përkatëse.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e viteve të dyta e lart të rishqyrtohen e të miratohen nga vetë shkollat dhe universitetet ose nga institucionet përkatëse.

9. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për vitin shkollor 2002-2003, i jepen 900 bursa për arsimin e mesëm dhe 1 100 bursa për arsimin e lartë. Planshpërndarja e bursave për çdo rreth bëhet sipas kërkesave të ardhura nga drejtoritë arsimore.

10. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga viti i dytë e lart, për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë data 15 nëntor 2002.

11. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për arsimin e lartë, viti i parë, të jetë data 30 nëntor 2002.

12. Kuotat financiare të ushqimit në mensa ndryshohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave, në varësi të indeksit të çmimeve të konsumit, por jo më shumë se një herë në vit.

13. Efektet financiare që rrjedhin nga rritja e kuotës së fjetjes, për vitin shkollor 2002-2003, të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

14. Trajtimi ushqimor i nxënësve bursistë, konviktore, të përballohet nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

15. Çdo vendim apo udhëzim në fuqi për bursën, kuotën ushqimore, veshmbathjen dhe shpenzimet të tjera për nxënësit dhe studentët, nxënësit e arsimit special dhe jetimët shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS PASQYRA NR. 1

në lekë

Nr.	Përbërja familjare	Të ardhurat për frymë në familjet e nxënësve		
		Bursa	Gjysmëbursa	Me pagesë
1	Për familjet me 2 persona	1550	1550-2650	mbi 2650
2	Për familjet me 3 persona	1350	1350-2350	mbi 2350
3	Për familjet me 4 persona	1250	1250-2300	mbi 2300
4	Për familjet me 5 persona	1150	1150-2200	mbi 2200
5	Për familjet me 6 persona	1050	1050-2145	mbi 2145
6	Për familjet me 7 persona	1000	1000-2100	mbi 2100
7	Për familjet me mbi 7 persona	900	900-2000	mbi 2000

Shënim: Nxënësit nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70 për qind të bursës së plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme, të tjerët me pagesë.

KUSHTET EKONOMIKE TË STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS PASQYRA NR. 2

në lekë

Nr.	Përbërja familjare	Të ardhurat për frymë në familjet e nxënësve		
		Bursa	Gjysmë bursa	Me pagesë
1.	Për familjet me 2 persona	1980	1980-3190	mbi 3190
2.	Për familjet me 3 persona	1760	1760-2860	mbi 2860
3.	Për familjet me 4 persona	1650	1650-2800	mbi 2800
4.	Për familjet me 5 persona	1485	1485-2750	mbi 2750
5.	Për familjet me 6 persona	1375	1375-2673	mbi 2673
6.	Për familjet me 7 persona	1300	1300-2596	mbi 2596
7.	Për familjet me mbi 7 persona	254	1254-2486	mbi 2486

Shënim: Studentët nga fshati përfitojnë bursë të plotë kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70 për qind të bursës së plotë kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme, të tjerët me pagesë.

NIVELI I BURSËS DHE KUOTËS USHQIMORE PËR STUDENTIN
PASQYRA NR. 3

në lekë

Nr.	Kategoritë e studentëve sipas shkollave	Bursa	Myra e mbulimit		Mënyra e shpenzimit		Fjetja	
					Ushqimi			
			Nga buxheti	Nga studenti	Nga buxheti	Nga studenti	Nga buxheti	Nga studenti
1.	Universitetet, Akademia e Arteve dhe Shkolla e lartë e Infermierisë							
	Bursa	7500	7500		6500		1000	
	Gjysmë bursa	7500	3750	3750	3250	3250	500	500
	Me pagesë			7500		6500		1000
2.	Akademia e Edukimit Fizik							
	Bursa	8100	8100		7100		1000	
	Gjysmëbursa	8100	4050	4050	3550	3550	500	500
	Me pagesë			8100		7100		1000

NIVELI I BURSËS DHE I KUOTËS USHQIMORE PËR NXËNËSIT
PASQYRA NR. 4

në lekë

Nr.	Kategoritë e nxënësve sipas shkollave	Bursa	Mënyra e mbulimit		Mënyra e shpenzimit	
			Nga buxheti	Nga nxënësi	Ushqimi	Shpenzime të vogla
1	Shkolla 8-vjeçare e të mesme					
	Bursa	4500	4500		4350	150
	Gjysmëbursa	4500	2250	2250	4350	150
	Me pagesë			4350	4350	
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive					
	Bursa	4950	4950		4800	150
	Gjysmëbursë	4950	2475	2475	4800	150
	Me pagesë			4800	4800	
3	Shkolla e Futbollit					
	Bursa	5650	5650		5500	150
	Gjysmëbursë	5650	2825	2825	5500	150
	Me pagesë			5500	5500	

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES
PASQYRA NR. 5

në lekë

Nr	Emërtimi	Kuotat financiare të veshmbathjes për një vit kalendarik
1.	Për fëmijët e shtëpisë të moshës parashkollore	5000
2.	Për fëmijët e shtëpisë të moshës shkollore dhe të institucioneve të nxënësve që nuk dëgjojnë, nuk flasin dhe nuk shikojnë	7000
3.	Për jetimët e shkollave të mesme dhe të larta	10000

Niveli i bursës dhe i kuotës ushqimore për nxënësin e arsimit special
Pasqyra nr. 5/1

në lekë

Nr.	Kategoritë e nxënësve sipas shkollave	Bursa	Mënyra e mbulimit		Mënyra e shpenzimit	
			Nga buxheti	Nga nxënësi	Ushqimi	Shpenzime të vogla
1.	Nxënësit jetim dhe të institucioneve speciale	5300	5300		5150	150

Kuota ushqimore ditore për nxënësin dhe studentin
Pasqyra nr. 6

në lekë

1. Universitete, Akademia e Arteve dhe Shkolla e Lartë e Infermierisë	216.6 lekë në ditë
2. Studentë të ILKF "Vojo Kushi"	236.6 lekë në ditë
3. Nxënës të shkollave tetëvjeçare dhe të mesme	145 lekë në ditë

KUOTA FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIM TË STUDENTËVE
PASQYRA NR. 7

Nr	Emërtimi	Njësia matjes	Norma mes.ditore	Çmimi mesatar	Vlera
1.	Bukë	gram	600	66	39.6
2.	Makarona	gram	30	88	2.64
3.	Oriz	gram	30	88	2.64
4.	Sheqer	gram	55	85	4.68
5.	Fasule	gram	35	144	5.04
6.	Patate	gram	200	60	12
7.	Perime	gram	300	75	22.6
8.	Fruta	gram	100	100	10
9.	Vaj	gram	30	190	5.7
10.	Gjalp	gram	15	520	7.8
11.	Mish	gram	100	600	60
12.	Qumësht	gram	200	40	8
13.	Djath	gram	40	350	14
14.	Reçel	gram	40	250	10
15.	Vezë	kokrra	1	10	10
16.	Çaj, erëza etj.	gram			1.9
	Kuota ditore				216.6